



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/52

Datë: 24.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr. 09/50, i datës 21.12.2020, si në vijim:
 - 1.1. Mjetet e ndara sipas vendimit nr. 09/50, në organizatën buxhetore Komuna e Lipjanit me kod 613, në nën-programin "Infrastruktura Publike - Lipjan" me kod 18163, në projektin kapital "Ndërtimi i objektit të ri të administratës së Komunës së Lipjanit" me kod 47780, në shumë 543,347 € (pesëqind e dyzetë e tremijë e treqind e dyzetë e shtatë euro), kthehen në organizatën buxhetore Ministria e Pushtetit Lokal me kod 212, në nën-programin "Administrata Qendrore" me kod 11312, në projektin kapital "Ndërtimi i objektit të ri të administratës së Komunës së Lipjanit" me kod 15888.
 - 1.2. Mjetet në shumë 543,347 € (pesëqind e dyzetë e tremijë e treqind e dyzetë e shtatë euro) të kthyer sipas pikës 1.1 të këtij vendimi, transferohen në: organizatën buxhetore Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me kod 207, në nën-programin Sportet e Gjëra me kod 80100, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe transfere" në vlerë 250,000 € (dyqind e pesëdhjetë mijë euro) si dhe në organizatën buxhetore Ministria e Mbrojtjes me kod 217, në nën-programin "Forca e Sigurisë e Kosovës" me kod 36000, në projektin kapital "Modernizimi i Sistemit të Sigurisë në MM" me kod 15580 në vlerë 193,588.20 € (njëqind e nëntëdhjetë e tremijë e pesëqind e tetëdhjetë e tete euro e njëzet cent) dhe në projektin "Autoblindat" me kod 12776, në vlerë 99,758.80 € (nëntëdhjetë e nëntëdhjetë e shtatëqind e pesëdhjetë e tete euro e tetëdhjetë cent).
2. Obligohet Ministria e Financave, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Mbrojtjes, për zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/52

Datë: 24.12.2020


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjetet shtesë financiare në vlerë prej 1,598,100.00 € (një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e tetëmijë e njëqind euro), në kategorinë e shpenzimeve "Paga dhe shtesa", për organizatën buxhetore Ministria e Punëve të Brendshme, nën-programi "Shërbimet administrative" me kod 30000, për zyrtarët aktiv policorë për angazhimin e shtuar në terren dhe të ekspozuar drejtpërdrejt në zbatimin e detyrave në menaxhimin e pandemisë COVID-19, sipas kërkesës dhe listës së bashkëlidhur nga Ministria e Punëve të Brendshme.
2. Mjetet për zbatimin e këtij vendimi ndahen nga burimet e financimit si vijon:
 - 2.1. Ministria e Financave, nën-programi "Kontigjencat në MF" me kod 26800, kategoria e shpenzimeve "Mallra dhe shërbime" 775,647 € (shtatëqind e shtatëdhjetë e pesëmijë e gjashtëqind e dyzetë e shtatë euro), kategoria e shpenzimeve "Shpenzime komunale" 17,525 € (shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e njëzetë e pesë euro) dhe kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe transfere" 500,000 euro (pesëqind mijë euro);
 - 2.2. Shpenzimet e paparashikuara, nën-programi "Shpenzimet e paparashikuara" me kod 13100, kategoria e shpenzimeve "Rezervat", 304,928 € (treqind e katërmijë e nëntëqind e njëzetë e tetë euro).
3. Shuma e mjeteve shtesë financiare sipas pikës 1 të këtij vendimi, ndahet për 6,124 zyrtarë policorë, në shumën prej 100 (një qind) euro në muaj për secilin për muajt aktiv, në periudhën Tetor, Nëntor dhe Dhjetor, sipas listës emërore të aprovuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës, bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Shtesa mbi pagë sipas pikës 3 të këtij vendimi, realizohet së bashku me pagën e muajit dhjetor 2020, përmes Sistemit të Pagave.
5. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, Ministria e Financave dhe Thesari për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 03/52
Datë: 24.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L -249 për Sigurimin Shëndetësor, dhe nenit 5 dhe 6 të Statutit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Plotësohet dhe ndryshohet Vendimi Nr. 12/26 i datës 21.08.2020 i Qeverisë së Republikës së Kosovës me të cilin është emëruar Bordi drejtues i Fondit për Sigurime Shëndetësore (FSSH), si në vijim:
 - 1.2. Hykmete Bajrami nga Ministria e Financave zëvendësohet me z. Ermal Lubishtani.
2. Pjesa tjetër e vendimit mbetet e pandryshuar.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/52

Datë: 24.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit në Kosovë.
2. Ministria e Financave vendos lidhur me shpërndarjen dhe publikimin e Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar të Pastrimit dhe Financimit të Terrorizmit në Kosovë.
3. Në rast të mos publikimit, obligohet Ministria e Financave të publikojë një përmbledhje të vlerësimit dhe listën e masave të nevojshme që duhen të ndërmerren menjëherë.
4. Obligohet Ministria e Financave t'i rekomandojë Qeverisë së Republikës së Kosovës strategjitë dhe masat tjera trajtuese të nivelit kombëtar.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/52

Datë: 24.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani i Veprimit i rekomanduar për përmirësimin e sistemit të Luftimit të Pastrimit të Parave/Luftimin e Financimit të Terrorizmit (efektiviteti) si dhe Shtojca 1 (pjesa teknike), Shtojca 2 (Udhëzues për zbatimin e mjetit për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Raportit të Vlerësimit), Shtojca 3 (Mjet për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve nga raporti i vlerësimit).
2. Njësia për Intelgjencë Financiare e Republikës së Kosovës caktohet të bëjë monitorimin e duhur të zbatimit të rekomandimeve të Raportit të Vlerësimit për t'i mundësuar që të rishikojë efektivitetin e sistemit kombëtar dhe për të bërë rekomandime në përputhje me rrethanat siç kërkohet sipas nenit 14 të Ligjit nr. 05/L -096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.
3. Krijohet grupi i punës me pjesëmarrje të institucioneve të listuara në shtojcë të këtij vendimi, për të bashkërenduar aktivitetet në fushën e politikave shtetërore të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe përcaktimin e prioriteteve afatgjata dhe afatshkurtra.
4. Obligohen institucionet e Republikës së Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- NJIF-K
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/52

Datë: 24.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24A, Paragrafi 1, i Ligjit Nr. 04/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, Ligjin Nr. 07/L - 003 për Ratifikimin e marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Fuqizimit të Sektorit Financiar, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, bazuar në Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2020-2023 i aprovuar me vendimin e Qeverisë nr.01/02 datë 05.06.2020, në zbatim të vendimit të Qeverisë nr. 01/23 të datës 13.08.2020, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Autorizohet transferimi i mjeteve në shumë prej njëzetë e një milionë e pesëqind e dhjetë mijë euro (21,510,000.00 euro), nga fondet e huamarrjes nga Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, të ndara në Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike me kod të nën-programit 29300, në kategoritë ekonomike shpenzime kapitale në shumën njëzetë e një milionë e katërqind e dhjetë mijë euro (21,410,000.00 €) dhe në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere në shumën njëqind mijë euro (100,000.00 €), në emër të rritjes së kapitalit të Fondit, si dhe mbulimin e shpenzimeve operacionale, përkatësisht.
2. Mjetet nga pika 1 e këtij vendimi, ndahen dhe transferohen në nën-programin e Thesarit me kod 11200, kategoria subvencione dhe transfere, me qëllim të transferimit të tyre te organizata jo-buxhetore Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, bazuar në nenin 24A, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 07/L-014 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit me Nr.07/L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020, si dhe Ligjin Nr. 07/L - 003 për ratifikimin e marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Fuqizimit të Sektorit Financiar.
3. Autorizohet Thesari që, mjete e ndara sipas paragrafit 2 të këtij vendimi, bazuar në Marrëveshjen Plotësuese të nënshkruar me datë 17.09.2020 në mes të Qeverisë së Kosovës e përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, të bëjë transferin e mjeteve në llogaritë e dedikuara të përfituesit Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, të përcaktuara në Memorandumin Fondit Kosovar për Garanci Kreditore të datës 06 Tetor 2020, në pajtim me legjislacionin dhe qëllimin e përdorimit të këtyre mjeteve.
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Thesari i Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.


Arsyetim

Në llogarinë e dedikuar të Thesarit të Republikës së Kosovës, brenda vitit 2020 do të pranohet mjetet nga kredia e disbursuar nga marrëveshja financiare ndërkombëtare, e ratifikuar me Ligjin Nr. 07/L - 003 për Ratifikimin e marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Fuqizimit të Sektorit Financiar. Këto mjete janë të parapara për rritjen e kapitalit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, në funksion të zbatimit të Ligji Nr. 07/L-016 Për Rimëkëmbjen Ekonomike - COVID-19, si dhe mbulimin e disa shpenzimeve operative, të lejuara në dokumentet shoqëruese të marrëveshjes financiare.

Mjetet për këtë kredi janë të parapara në kuadër të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike (PRE), të cilat për t'u shpenzuar, pasi të pranohen në llogari (disponueshmeria), në pajtim me legjislacionin, si dhe neni 24A, duhet të ndahen tek një organizatë buxhetore, përkatësisht tek Thesari, për rastin kur ato dedikohen për një organizatë jo-buxhetore.

Pas plotësimit të kushteve formale që kanë të bëjnë me pranimin e mjeteve në llogari, mjetet ndahen tek Thesari sipas këtij vendimi dhe në pajtim me autorizimin e Nenit 24A, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 07/L-014 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit me Nr.07/L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2020, mjetet e ndara të huamarrjes do të transferohen në llogaritë e dedikuara të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.

Avdullah HOTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë MF-së dhe Thesarit



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/52

Datë: 24.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për shpronësimin e 121 veprave të artit të autorëve bashkëkohor, të cilat ndodhen në objektin e Ndërmarrja e Re Hotel Grand SH.P.K, si ndërmarrje e cila është nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
2. Veprat e artit sipas pikës një të këtij vendimi do të bartën në Galerinë Kombëtare të Kosovës e cila do të kujdeset për ruajtjen dhe mbrojtjen e tyre.
3. Në rast të nevojës për vlerësimin e veprave artistike, me qëllim të zbatimit të nenit 6A paragrafi 3, nenit 8.6.2 dhe nenit 8.6.3 të Ligjit nr. 04/L-034, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-80 dhe Ligjin nr. 04/L-115, të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, atëherë Qeveria do të themeloj një komision të veçantë.
4. Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi është lista me të gjitha të dhënat për veprat e artit.
5. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe institucionet tjera relevante që të ndërmarrin të gjitha masat për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e informuar që në ambientet e Ndërmarrja e Re Hotel Grand SH.P.K, e cila është nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit ndodhen një numër i konsiderueshëm (121) i veprave të artit të disa nga artistëve më të mirë vendor të kohës sonë, duke qenë e vetëdijshme për rëndësinë madhe që kanë këto vepra të artit për historinë më moderne të artit tonë, në periudhën fundit ka koordinuar me Agjencinë Kosovare të Privatizimit procedurat për bartjen e pronësisë së koleksionit të veprave të tilla të artit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, gjegjësisht në Galerinë Kombëtare të Kosovës si institucioni më i lartë i artit pamor në vend.

Nga Agjencia Kosovare e Privatizimit jemi informuar që për shkak se në vitin 2012 AKP i ka kthyer aksionet e ish-blerësit të Ndërmarrjes së Re "Grand Hotel" dhe i ka transferuar në administrim të AKP-së dhe më pastaj ndërmarrja "Grand Hotel" është vendosur në likuidim, atëherë sipas nenit 8.6.2 të Ligjit të AKP-së, punëtorëve të Ndërmarrjes së Re "Grand Hotel" nuk iu takon 20% nga transformimi i pronës. Për këtë arsye, në rast të shpronësimit të këtyre veprave artistike, Qeveria nuk obligohet të paguaj 20% nga vlera e shpronësimit, por obligohet të paguaj deri në vlerën e shumës së shpronësuar sipas nenit 6A paragrafi 3 i Ligjit të AKP-së dhe atë në rastet se nuk ka fonde të mjaftueshme në llogarinë bankare të Ndërmarrja e Re Grand Hotel (në likuidim) sipas nenit 8.6.2 të Ligjit të AKP-së dhe prioriteteve të nenit 40 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së si dhe Ndërmarrjes Shoqërore KHT Kosova (sipas nenit 8.6.3 të Ligjit të AKP-së), gjithnjë pas shqyrtimit të ankesave nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës

Sipas informatave nga AKP, kreditorët e aprovuar të Ndërmarrjes së Re "Grand Hotel" (në likuidim) janë në vlerën EUR 990,830, janë 162 ankesa të njohura në vlerën totale prej EUR 47,381,188 dhe 5 ankesa të panjohura.

Në rast se AKP konfirmon me shkrim Qeverisë së Kosovës se nuk ka fonde të mjaftueshme për pagesën e kreditorëve, atëherë Qeveria do të themeloj një komision të veçantë për vlerësimin e veprave artistike në mënyrë që të përmbushë obligimin për pagesën e shpronësimit sipas nenit 6A paragrafi 3 të Ligjit të AKP-së.

Për të përgatitur procesin e kthimit të veprave të tilla në Galerinë Kombëtare të Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim me Agjencinë Kosovare të Privatizimit kanë krijuar një komision për inventarizimin e veprave të artit që gjenden në Ndërmarrjen e Re Hotel Grand sh.p.k. (në likuidim). Qëllimi i procesit të inventarizimit ishte evidentimi i veprave artistike të gjendura në Ndërmarrjen e Re Hotel Grand sh.p.k. (në likuidim).


Në komisionin e inventarizimit morën pjesë përfaqësues të Ndërmarrjes së Re Hotel Grand sh.p.k. (në likuidim) dhe të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve. Komisioni më 28 Janar 2015 evidentoi 121 vepra artistike në ambientet e Ndërmarrjes së Re Hotel Grand sh.p.k. (në likuidim), të cilat janë të listuara në listën e bashkëngjitur në këtë propozim vendim.

Këto vepra janë ndër veprat më të mira të kohës dhe janë pjesë e pashlyeshme e historisë së artit bashkëkohor të Kosovës, andaj Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e kulturës e konsideron të rëndësishme të bëhet bartja e pronësisë së këtyre veprave të artit si dhe vendosja e tyre në ambientet institucionet shtetërore të kulturës e artit, konkretisht në Galerinë Kombëtare të Kosovës dhe të sigurohet hapësira për promovimin e këtyre veprave, të cilat janë edhe pjesë e imazhit të artit modern të Republikës së Kosovës.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim me Galerinë Kombëtare të Kosovës obligohet që do të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar hapësirat e përshtatshme për vendosjen e tyre si dhe do të ndërmerr të gjitha masat për të bërë transportin në mënyrë të sigurtë.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bashkëpunim me Galerinë Kombëtare të Kosovës ju siguron që do të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar hapësirat e përshtatshme për vendosjen e tyre si dhe do të ndërmarrim të gjitha masat për të bërë transportin në mënyrë të sigurtë, meqë këto vepra janë tejet të ndjeshme.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/52

Datë: 24.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17, 19 dhe 27 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

për shfuqizimin e pjesshëm të Udhëzimit Administrativ (MTI) - Nr. 06/2019, për Kushtet Teknike për Import, Deponim, Shitje me Shumicë, Shitje me Pakicë të Karburanteve të Naftës dhe Pastrim të Rezervuarve, i ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ (MTI) - Nr. 15/2020

1. Shfuqizohet neni 6 i Udhëzimit Administrativ (MTI) - Nr.06/2019, për Kushtet Teknike për Import, Deponim, Shitje me Shumicë, Shitje me Pakicë të Karburanteve të Naftës dhe Pastrim të Rezervuarve, si dhe Udhëzimi Administrativ (MTI) - Nr. 15/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MTI) - Nr.06/2019, për Kushtet Teknike për Import, Deponim, Shitje me Shumicë, Shitje me Pakicë të Karburanteve të Naftës dhe Pastrim të Rezervuarve.
2. Në titullin e Udhëzimit Administrativ (MTI) - Nr.06/2019, për Kushtet Teknike për Import, Deponim, Shitje me Shumicë, Shitje me Pakicë të Karburanteve të Naftës dhe Pastrim të Rezervuarve, fshihet fjala "dhe Pastrim të Rezervuarëve".
3. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që ta zbatojë këtë vendim.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Neni 6 i Udhëzimit Administrativ (MTI) - Nr.06/2019, për Kushtet Teknike për Import, Deponim, Shitje me Shumicë, Shitje me Pakicë të Karburanteve të Naftës dhe Pastrim të Rezervuarve, i ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ (MTI) - Nr. 15/2020, parasheh se "Kompanitë të cilat bëjnë pastrimin e rezervuarve të karburanteve të lëngëta të naftës duhet të jenë të autorizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë".

Neni 17, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Lejet dhe Licencat) parasheh se lejet dhe licencat përcaktohen vetëm me ligj. Rrjedhimisht, asnjë e tillë nuk mund të përcaktohet me fuqinë e aktit nënligjor.

Lejimi në kuptimin e nenit 3, paragrafi 1.3 të Ligjit për Lejet dhe Licencat përkufizohet si "mekanizëm i kërkesave rregullative që autoriteti kompetent mund ta përdorë për të rregulluar veprimtarinë private dhe publike; llojet e lejeve dallojnë nga rreptësia e tyre, e cila duhet të jetë proporcionale me nivelin e rrezikut që paraqet veprimtaria që rregullohet".

Në këtë drejtim, detyrimi i kompanive për t'u autorizuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për të bërë pastrimin e rezervuarve të karburanteve të lëngëta të naftës, paraqet lejim në kuptimin e Ligjit për Lejet dhe Licencat, dhe si i tillë duhet paraparë me ligj.

Neni 5, paragrafi 3 (a) i Ligjit Nr. 03/L-138 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/5 për Tregtinë me Naftë dhe Derivate të Naftës në Kosovë përcakton se:

a) *Licencat do të jepen për import, deponim, shitje me shumicë, shitje me pakicë, dhe përpunim.*
Pra, ky ligj nuk parasheh në asnjë nga dispozitat e tij detyrimin e kompanive për pastrimin e rezervuarve të karburanteve të lëngëta të naftës, apo mirëmbajtjen e tyre. Andaj, ky detyrim nuk mund të parashihet me fuqinë e aktit nënligjor, gjegjësisht, nenin 6 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2019 për Kushtet Teknike për Import, Deponim, Shitje me Shumicë, Shitje me Pakicë të Karburanteve të Naftës dhe Pastrim të Rezervuarve, të ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ (MTI) - Nr. 15/2020 për shkak se bie në kundërshtim me nenin 17, paragrafi 1 të Ligjit për Lejet dhe Licencat.

Në vijim të kësaj që u tha më lartë dhe të kërkesës me nr. prot.2295, të pranuar me datë 28.09.2020, të parashtruar nga Shoqata e Naftarëve të Kosovës, për shfuqizimin e udhëzimit administrativ në fjalë, pas konsumimit të procedurës sipas nenit 27 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë, Qeveria e Republikës së Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Anëtarëve të Komisionit Ekzekutiv
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/52

Datë: 24.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

për shfuqizimin e pjesshëm të Udhëzimit Administrativ (MTI) - Nr. 11/2020 për Përcaktimin e Kushteve dhe Kritereve për Subjektet që merren me Tregtimin e Duhanit dhe Produkteve të tij, i ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ (MTI) - Nr. 16/2020

1. Shfuqizohet neni 15 i Udhëzimit Administrativ (MTI) - Nr. 11/2020 për Përcaktimin e Kushteve dhe Kritereve për Subjektet që merren me Tregtimin e Duhanit dhe Produkteve të tij, si dhe shfuqizohet neni 3 i Udhëzimit Administrativ (MTI) - Nr. 16/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MTI) - Nr. 11/2020 për Përcaktimin e Kushteve dhe Kritereve për Subjektet që merren me Tregtimin e Duhanit dhe Produkteve të tij.
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që të ndryshojë dhe plotësojë Udhëzimin Administrativ (MTI) - Nr. 11/2020 për Përcaktimin e Kushteve dhe Kritereve për Subjektet që merren me Tregtimin e Duhanit dhe Produkteve të tij, i ndryshuar dhe plotësuar me Udhëzimin Administrativ (MTI) - Nr. 16/2020, ku do të përcaktojë shumat e taksave në përputhje me parimin e mos pagesës së procedurës, të përcaktuar në nenin 12 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 18 të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave.
3. Deri në nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ për Përcaktimin e Kushteve dhe Kritereve për Subjektet që merren me Tregtimin e Duhanit dhe Produkteve të tij, sipas pikës 2 të këtij vendimi, subjektet të cilat merren me tregtimin e duhanit janë të liruar nga pagesa e taksave për licencim.
4. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që ta zbatojë këtë vendim.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Neni 15 i Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 11/2020 për Përcaktimin e Kushteve dhe Kritereve për Subjektet që merren me Tregtimin e Duhanit dhe Produkteve të tij, i ndryshuar dhe plotësuar Udhëzimin Administrativ (MTI) - Nr. 16/2020, parashih shumat e taksës për licencim të subjekteve të cilët merren me tregtimin e duhanit. Lartësitë e shumave të taksave të përcaktuara me këtë nen bien ndesh me nenin 12 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 18 të Ligjit Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave, andaj, duhet bërë harmonizimi i këtij neni me legjislacionin në fuqi, përmes ndryshimit dhe plotësimit të tij nga organi propozues i këtij udhëzimi administrativ.

Në vijim të kësaj që u tha më lartë dhe në mënyrë që Republika e Kosovës të përmbushë obligimet ligjore që rrjedhin nga treguesi 5.3 i "Kontratës për Përkrahjen Buxhetore Direkte" në kuadër të *Marrëveshjes financiare me Bashkimin Evropian për IPA 2016, pjesa e dytë* lidhur me thjeshtësimin, eliminimin ose bashkimin e lejeve dhe licencave në Republikën e Kosovës, pas konsumimit të procedurës sipas nenit 27 të Rregullores Nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë, Qeveria e Republikës së Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Avdullah HOTTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Anëtarëve të Komisionit Ekzekutiv
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/52

Datë: 24.12.2020


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 59 pika 5 dhe 9 të Ligjit nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-158, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e katër (4) anëtarëve të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, i emëruar me Vendim të Qeverisë Nr. 05/15 me datën 22.07.2020 i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin e Qeverisë Nr. 05/31 me datën 21.09.2020.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës për katër (4) anëtarëve të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, këta kandidatë:
 - 2.1. Festim Kutlllovc
 - 2.2. Ibrahim Krasniqi;
 - 2.3. Skender Sallahu;
 - 2.4. Hasan Fejzullahu;
 - 2.5. Muharrem Sejdiu;
 - 2.6. Xhavit Rraci;
 - 2.7. Basri Kokolli;
 - 2.8. Sali Mulaj;
 - 2.9. Burim Fetaj;
 - 2.10. Ibush Luzha;
 - 2.11. Bujar Hasimi;
 - 2.12. Kreshnik Rugova.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që emërat dhe biografitë të të propozuarve nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedoj Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HODI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/52
Datë: 24.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Enërgjisë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për Kryesues të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Enërgjisë i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës këta kandidatë:
 - 1.1. Vehbi Safiu;
 - 1.2. Luan Morina;
 - 1.3. Bekim Jakupi.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që emërat dhe biografitë të të propozuarve nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedoj për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/52

Datë: 24.12.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 dhjetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerën prej njëqind e pesë mijë euro (105,000.00 €), për dhjetë (10) OJQ-të/Strehimoret e licencuara të cilat ofrojnë shërbime për mbrojtje të fëmijëve, strehimin e viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit.
2. Mjetet financiare sipas pikës një (1) të këtij vendimi ndahen nga nën-programi me kod 001500-Shpenzimet bazike për strehimoret, kategoria shpenzimeve subvencione dhe transfere.
3. Obligohet Ministria e Punë dhe Mirëqenies Sociale që shumën e mjeteve financiare nga pika një (1) e këtij vendimi të ndajë në këto shuma për Strehimoret/OJQ-të;
 - 1.1. Për strehimoren "Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve" në Prishtinë, ndahet shuma prej dhjetë mijë euro (10,000.00 €) në xhirollogarinë me Nr. 1110052260000121;
 - 1.2. Për strehimoren "Qendra për mbrojtjen dhe rehabilitimin e grave dhe fëmijëve-Liria" në Gjilan, ndahet shuma prej dhjetë mijë euro (10,000.00 €) në xhirollogarinë me Nr.1507001000682963;
 - 1.3. Për strehimoren "Qendra për strehimin e grave dhe fëmijëve" në Prizren, ndahet shuma prej dhjetë mijë euro (10,000.00 €) në xhirollogarinë me Nr. 1404000003714159;
 - 1.4. Për strehimoren "Qendra për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve-Raba Voca" në Mitrovicë, ndahet shuma prej dhjetë mijë euro (10,000.00 €) në xhirollogarinë me Nr. 1160686109000124;
 - 1.5. Për strehimoren "Shtëpia e Sigurt "në Gjakovë, ndahet shuma prej dhjetë mijë euro (10,000.00 €) në xhirollogarinë me Nr.1306001200001144;
 - 1.6. Për strehimoren "Qendra për Mirëqenien e Gruas" në Pejë, ndahen shuma prej dhjetë mijë euro (10,000.00 €) në xhirollogarinë me Nr. 1130062827000156;
 - 1.7. Për strehimoren "Qendra e Gruas-Shtëpia Ime" në Ferizaj, ndahet shuma prej dhjetë mijë euro (10,000.00 €) në xhirollogarinë me Nr.1189005918000179;

- 1.8. Për strehimoren "Qendra për mbrojtjen e viktimave dhe parandalimin e trafikimit" në Prishtinë ndahet shuma prej dhjetë mijë euro (10,000.00 €) në xhirollogarinë me Nr.1110165139000128;
 - 1.9. Për strehimoren "Zenski Inkluzivni Centar" në Novobërdë ndahet shuma prej dhjetë mijë euro (10,000.00 €) në xhirollogarinë me Nr.1701017700008672;
 - 1.10. Për ofrimin e shërbimeve rezidenciale për fëmijë nga OJQ "Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve" në Prishtinë, ndahet shuma prej pesëmbëdhjetë mijë euro (15,000.00 €) në xhirollogarinë me Nr.1501110000259256.
4. Mjetet financiare të përcaktuara sipas pikës tre (3) të këtij vendimi do të shfrytëzohen nga Strehimoret/OJQ-ët, për financimin e ofrimit të shërbimeve për fëmijë, viktimë të dhunës në familje dhe viktimë të trafikimit për muajin Janar dhe Shkurt të vitit 2021, gjatë kësaj periudhe MPMS do të zhvillojë procedurat e shpalljes së thirrjes publike për mbështetje të OJQ-ve për vitin 2021.
 5. Për mjetet financiare të shfrytëzuara nga pika tre (3) e këtij vendimi Strehimoret/OJQ-të, janë të obliguara të dorëzojnë raportet narrative dhe financiare në Departamentin e Politikave Sociale dhe Familjes dhe Divizionin për Buxhet dhe Financa në MPMS.
 6. Për zbatimin e këtij vendimi, obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
 7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Gjendja emergjente e shkaktuar me COVID-19 sikurse në të gjithë botën edhe në Kosovë ka rënduar në masë të madhe grupet e cenushme dhe kjo ka ndikuar në rritjen e numrit të rasteve të dhunës në familje. Pandemia ka ndikuar edhe në shumë sfera dhe ka rënduar gjendjen socio-ekonomike të Qyettarëve të Kosovës ku si pasojë është rritur edhe numri i fëmijëve pa perkujdesje prindërore. Per shkak të situatës së tashme të rënduar dhe më qëllim të lehtësimit në kryrjen e obligimeve për këto OJQ, bazuar në opinionin ligjor të Departamentit të Buxhetit të Ministrisë së Financave të datës 23.12.2020, me nr. 4408/2, aprovohet kërkesa me nr. 4408 e datës 23.12.2020, për mbështetje financiare për dhjetë (10)-të OJQ-të/Strehimoret e licencuara të cilat ofrojnë shërbime për mbrojtje të fëmijëve, strehimin e viktimave të dhunës në familje dhe viktimave të krimit.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Strehimoreve\OJQ-ve
- Arkivit të Qeverisë